



8. EDI

EDI është shkurtësë e fjalës deklarim elektronik apo E-deklarimi. Është një mënyrë më e avancuar, e shpejtë dhe e lehtë e deklarimit dhe pagesës së tatimit. Ky sistem u lejon të krijoni një llogari online me ATK-në, ku ju mund të plotësoni dhe deklaroni deklaratat tatimore si dhe të kontrolloni historinë tuaj tatimore.

9. Qendra e thirrjeve

Qendra e thirrjeve ofron shërbime për tatimpaguesit duke i njoftuar për: borxhet që kanë ndaj ATK-së, deklaratat që mungojnë në sistem, mundësitë e pagesës së borxhit, mënyrën e pagesës së borxhit, etj.

10. Lajmërimi i korrupsionit të stafit të ATK-së dhe evazionit tatimor

ATK ju ofron mundësinë që pa pagesë, të lajmëroni rastet e evazionit tatimor, korrupsionit, apo sjelljeve jo të mira të stafit të ATK-së nëpërmjet linjës telefonike pa pagesë nga:  dhe 

 **0800-80-800**

**Pagesa e tatimit, siguron
qëndrueshmëri të
ekonomisë në vend!**

Kontaktet e ATK-së

Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ne ju inkurajojmë që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen tonë të internetit www.atk-ks.org. Nëse nuk jeni në gjendje të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar, prandaj drejtohuni në zyret më të afërta të ATK-së:

Telefonat:

NJTM : 038/200 346 41

Prishtina-1: 038/200-255-21

Prishtina-2: 038/200-255-02

Prishtina-3: 038/200-255-17

Prizreni: 029/244-963

Peja: 039/432-812

Ferizaj: 0290/321-668

Gjilani: 0280/326-967

Mitrovica: 028/590-667

Gjakova: 0390/330-021

Zyra Qëndrore: 038/200-250-17

Linja e përbashkët pa pagesë:

 **0800-80-800**

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 17 & 200 250 07
Email: info@atk-ks.org; Web: www.atk-ks.org



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

**INFORMATA TË
PËRGJITHËSHME
PËR ATK-në**

Fletëpalosja me informata të përgjithshme për ATK-në bazuar në Ligjin Nr. 03/L - 222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka për qëllim Edukimin dhe Informimin e Tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, të cilat rrjedhin nga ky ligj.

1. Misioni i Administratës Tatimore të Kosovës

- Të shtohet në maksimum përbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit tatimor;
- Të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve; dhe
- Të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëjloshëm si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblihdhen të hyra për buxhetin e Kosovës në një mënyrë efektive dhe me kosto të ultë.

2. Vizioni i Administratës Tatimore të Kosovës

- Të formojë dhe ta ruaj një imazh pozitiv për të mirën e shtetit të Kosovës;
- Të respektohet nga klientët tanë dhe të njihet nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare;
- Të përbëhet nga personeli profesionist dhe energjik që do të garantojnë një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimin e shërbimeve tona në raport me klientët tanë, përmes të cilës ne do të bëhemi burimi kryesor i të hyrave për shtetin e Kosovën.

3. Vlerat e Administratës Tatimore të Kosovës

- Integriteti dhe sinqeriteti janë gurë themeli i institucionit tonë, që sigurojnë një trajtim të barabartë ndaj tatimpaguesve dhe zbatim të drejtë të ligjeve;
- Profesionalizmi është çelësi i suksesit në përbushjen e misionit tonë, duke synuar në përmirësim të vazhdueshme drejt standardeve më të larta të suksesit;
- Transparenca është elementi kyç për ndërtimin e lidhjeve të forta me tatimpaguesit dhe të besimit në Administratën Tatimore.
- Respekti ndaj tatimpaguesve dëshmohehet përmes kontakteve tona në të cilat ne i pranojmë të drejtat e tyre dhe obligimet tona
- Fleksibiliteti është bazë për zhvillimet e reja në organizatën tonë

4. Avokati i Tatimpaguesve - Zëri juaj brenda ATK-së

Avokati i Tatimpaguesit vepron në kuadër të ATK-së dhe u shërben tatimpaguesve që kërkojnë ndihmë në zgjidhjen e problemeve me ATK-në apo atyre që besojnë që një procedurë e ATK-së nuk është zhvilluar sipas procedurave të parapara me legjislacion tatimor. Shërbimet e Avokatit të Tatimpaguesit janë pa pagesë.

Ju mund të kontaktoni Avokatin e Tatimpaguesit përmes:
e-mail adresës: avokati.tatimpaguesve@atk-ks.org, apo
ne numrin e telefonit +381 38 200 347 09

5. Pajisja me Numër Fiskal - NF

Numri Fiskal është numri i identifikimit të tatimpaguesit që ATK lëshon për çdo tatimpagues dhe përdoret për qëllime tatimore. Aplikacioni për numër fiskal duhet të dorëzohet në zyrën përkatëse regjionale të ATK-së dhe atë bnda 15 ditëve pasi që biznesi është regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës. Pajisja me Numër Fiskal bëhet brenda ditës së aplikimit.

6. Llojet e tatimeve dhe normat tatimore

Sistemi tatimor në Kosovë është pjesë e një politike kombëtare fiskale që është në linjë me praktikën më të mirë të Bashkimit Evropian. Bazuar në ligjet moderne, ATK praktikon metodën e vetë-deklarimit duke synuar të promovojë sistemin e drejtësisë, të rris përbushjen vullnetare, efektive dhe në kohë të duhur.

Tatimet dhe pensionet që i menaxhon ATK janë:

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar - TVSh që është 16 %
2. Tatimi në të Ardhura të Korporatave - TAK që është 10 %
3. Tatimi në të Ardhura Personale - TAP që tatóhet si në vijim:

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	Të ardhurat vjetore
0%	0 deri 80	0 deri 960
4%	80 deri 250	960 deri 3000
8%	250 deri 450	3000 deri 5400
10%	450 e tutje	5400 e tutje

4. Kontributet pensionale

Punëdhënësi	I punësuar	Gjithësejt
Minimum 5%	Minimum 5%	Minimum 10%
Maximum 15%	Maximum 15%	Maximum 30%

7. Formularët Tatimor dhe mënyra e deklarimit

Për të shkarkuar formularët tatimor, tatimpaguesit duhet të jenë të pajisur me Numër Fiskal, pasi që të gjithë formularët tatimor shkarkohen VETËM në mënyrë elektronike përmes webfaqes së ATK-së www.atk-ks.org dhe atë përmes Numrit Fiskal.

Vëmendje: "Formulari tatimor mund të përdoret vetëm një herë për një periudhë tatimore, prandaj çdo herë para se të bëni dorëzimin e deklaratës tatimore ju lutem së pari bëni shkarkimin elektronik të deklaratës përkatëse nga Uebi i ATK-së"

Numri fiskal:

Në vijim janë formularët tatimor që aplikohen si dhe shkurtesat e tyre:

Emertimi i Formularit	Shkurtesa
Pasqyra e tatimit mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar	IR
Pagesa tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e mëdha individuale	IL
Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale	IS
Pasqyra e mbajtjes në burim dhe pagimit të tatimit	WM
Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes të drejtat pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojra të fatit dhe personin jo-rezident	WR
Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për korporatat e vogla	QS
Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për korporatat e mëdha	QL
Deklarata e tatimit në të Ardhurat e Korporatave	CD
Formular deklarimi e pagese për TVSh	TV
Formular i Deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin mbi të Ardhurat Personale	PD
Pasqyra e kontributeve për pension dhe formulari i pagesës	CM
Kërkesë për Rimbursim dhe Rikthim/Kithim	KRR
Deklarata e Tatimit në të Ardhurat nga ortakëria	DO
Formulari i caktimit të punëdhënësit kryesor	FCKP
Autorizimi për informata tatimore	AIT

Vërejtje: Secili formular ka numrin identifikues - barkodin individual, prandaj për çdo deklarim duhet të shkarkohet formulari i posaçëm në mënyrë që të procesohet në databazën e ATK-së. Në tabelë, janë listuar formularët të cilët aktualisht përdoren, mirëpo, në adresën elektronike ku bëhet shkarkimi i formularëve ekzistojnë edhe formular të tjerë, të cilët janë përdorur më herët për periudhat dhe tatimet e mëparshme.